

Grante të

**BASHKËFINANCUARA PËR ZHVILLIM
TEKNOLOGJIK PËR RRITJE TË
PËRSHPEJTUAR EKONOMIKE**



QËLLIMI ●

Mbështetje për ndërmarrjet për të krijuar kushte për tejkalimin e pasojave të krizës ekonomike, të arrijnë rritje të përshpejtuar, të rrisin konkurrencën në tregjet ndërkombëtare dhe rezistencën ndaj krizave pandemike dhe klimatike, përmes prezantimit të teknologjive të reja, inovative, të avancuara, “gjelbra” dhe digjitale për transformimin e tyre.

ÇFARË PROJEKTE PO KËRKOJMË?

- Furnizimi dhe vendosja e teknologjive të reja, inovative, të avancuara, 'të gjelbra' dhe digjitale për transformimin e proceseve të prodhimit dhe të biznesit;
- Zhvillimi dhe vendosja e proceseve dhe standardeve të reja më ekologjike për prodhim dhe punë;
- Furnizimi dhe vendosja e zgjidhjeve të reja digjitale (softuer, vegla, licenca, etj.) dhe zhvillimi i modeleve digjitale të biznesit, që mund të përfshijnë digjitalizimin e kanaleve të shitjeve dhe furnizimit;
- Ngritja e kapaciteteve të menaxhmentit dhe punonjësve për aplikimin e teknologjive të reja; Përmirësimi i produktivitetit dhe efikasitetit të prodhimit dhe/ose proceseve të biznesit;
- Zvoglimi i shpenzimeve të prodhimit dhe funksionit operativ;

* Lista e aktiviteteve nuk është e kufizuar.





BUXHETI I PËRGJITHSHËM I THIRRRJES 5 MILION EURO



FIZHT BASHKËFINANCIMI

MIKRO NDËRMARRJE - deri në 70%

Nga buxheti i përgjithshëm i projektit, por jo më shumë se 2.500.000.00 denarë për ndërmarrjet dhe ISHP, numri mesatar i të punësuarve të të cilëve është deri në 10 punëtorë dhe të ardhurat vjetore të të cilëve në dy vitet e fundit janë më pak se 50.000.00 euro.

NDËRMARRJEVE TË VOGLA - deri në 70%

Nga buxheti i përgjithshëm i projektit, por jo më shumë se 5.000.000.00 denarë për ndërmarrjet dhe ISHP, numri mesatar i të punësuarve të të cilëve është nga 10 deri në 50 punëtorë dhe të ardhurat vjetore të të cilëve në dy vitet e fundit janë më të mëdha se 50.000.00 euro dhe më pak se 2.000.000.00 euro.

NDËRMARRJE TË MESME - deri në 60%

Nga buxheti i përgjithshëm i projektit, por jo më shumë se 10.000.000.00 denarë për ndërmarrjet dhe ISHP, numri mesatar i të punësuarve të të cilëve është nga 50 deri në 250 dhe të ardhurat vjetore të të cilit në dy vitet e fundit janë më të mëdha se 2.000.000.00 euro dhe më pak se 10.000.000.00 euro.

Kohëzgjatja e projektit mund të jetë deri në 18 muaj.

PËR KË DEDIKOHET?

- Të jetë shoqëri tregtare ose institucion privat shëndetësor;
- Të mos jetë i lidhur me një ndërmarrje tjetër dhe/ose ISHP, të ardhurat vjetore të së cilës i kalojnë 10,000,000 euro dhe se mesatarja e të punësuarve nuk i kalon 250 në dy vitet e mëparshme fiskale;
- Ndaj tij nuk është nisur asnjë procedurë falimentimi apo likuidimi;
- Të ketë shlyer obligimet e maturuara në bazë të detyrimeve dhe kontributeve publike;
- Kundër tij nuk ka filluar procedura për përmbarim të detyrueshëm të kërkesave monetare të maturuara;
- Aplikantët me më shumë se 3 (tre) vite ekzistencë deri në momentin e aplikimit nuk duhet të kenë pësuar humbje sipas pasqyrave financiare për dy vitet e fundit kalendarik;
- Nuk ka detyrime të maturuara dhe të papaguara me vonesë mbi 90 ditë ndaj institucioneve financiare, që nga fundi i shkurtit 2020, gjegjësisht para fillimit të krizës së shkaktuar nga Covid-19, sipas raportit të lëshuar nga Byroja Maqedonase e Kreditimit;
- Të plotësohen kushtet e Ligjit për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore dhe për të njëjtin qëllim/masë të mos merret ndihma shtetërore nga dy burime të ndryshme sepse një ndihmë e tillë nuk lejohet.



SHPENZIMET E PRANUESHME

- Pagat bruto për punonjësit e aplikantit që do të angazhohen në projekt. Shumat e pagave bruto të punonjësve të angazhuar në projekt duhet të korrespondojnë me praktikat e vendosura të përdoruesit përpara fillimit të projektit, të reduktuara me shumën e subvencionit të mundshëm shtetëror të marrë në bazë të pagës;
- Shpenzimet për mbështetje teknike (ekspertizë), shpenzimet për shërbime kontraktuale për hulumtim, zhvillim, digjitalizim;
- Shpenzimet për furnizimin dhe dhënien me qira të pajisjeve, softuerëve, mjeteve të teknologjisë së informacionit, lëndëve të para dhe materialeve harxhuese, të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e projektit;
- Shpenzimet që lidhen me zbatimin e planit të zhvillimit teknologjik të Aplikantit;
- Shpenzime të tjera operative që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e projektit, përveç atyre që nuk janë të pranueshme për financim nëpërmjet këtij Instrumenti.

Vetëm shpenzimet e bëra gjatë projektit në përputhje me buxhetin e projektit të miratuar dhe të realizuara deri në fund të projektit janë të pranueshme për financim.





MEKANIZMI I KTHIMIT TË MJETEVE



Kthimi i mbështetjes financiare të dhënë nga Fondi kryhet në masën 7.5% të fitimit operativ të përfituesit, deri në realizimin e një kthimi prej 105% të shumës së paguar nga Fondi ose për një periudhë 5-vjeçare pas përfundimit të projektit, në varësi se cili kusht plotësohet i pari.



KRITERET E EVALUIMIT TË PROJEKTEVE



35
PIKË

**PROGRESI
TEKNOLOGJIK DHE
SHKALLA E
DIGJITALIZIMIT**

10
PIKË

**CILËSIA E
PROJEKTIT**

10
PIKË

**KAPACITETI I EKITIT
TË PROJEKTIT**

45
PIKË


NDIKIMI

PËRPARËSI GJATË VLERËSIMIT KANË:

Projektet e ndërmarrjeve me drejtuese dhe/ose pronare gra;

Projektet nga rajonet më pak të zhvilluara;

Ndërmarrjet që kanë përfshirë në ekipin e projektit të paktën një docent, profesor universitar të asociuar ose të regullt dhe/ose doktorant që do të përfshihet në projekt.



PROCEDURA E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

01

VLERËSIMI I PARË – PËRZGJEDHJA PARAPRAKE

Projekti evaluohet nga tre ekspertë vendas nga 22 fusha të ekspertizës. Të gjitha projektet që marrin një rezultat mesatar prej të paktën 51 pikësh vazhdojnë në fazën tjetër

02

VLERËSIMI I DYTË – PËRZGJEDHJA

Projektet shqyrtohen nga Komiteti për Miratimin e Investimeve (KMI) – një organ i pavarur i përbërë nga një ekip prej pesë ekspertësh të huaj. Prezantimi publik (pitching) – opsionale (me kërkesë të KMI)

03

MARRJA E VENDIMIT PËRFUNDIMTAR

Komiteti për Miratimin e Investimeve merr vendimin përfundimtar për financimin e projekteve të propozuara

04

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES DHE FILLIMI I PROJEKTIT

AFATI PËR APLIKIM:
deri më 29.02.2024, ora 14:00.

Për të gjitha pyetjet shtesë, na shkruani në:



zabrzanrast2024@fitr.mk



www.fitr.mk